



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2022:173071

Datë: 26.02.2024

Numri i dokumentit: 05372946

C.nr.2905/2022

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni civil, me gjyqtarin Baki Shigjeqi, me bashkëpunëtoren profesionale H.D. duke vendosur në çështjen juridike kontestimore të paditëses D.B.K. me numër personal nga Prizreni, të cilën me autorizim e përfaqëson A.H. avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit, Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën me autorizim e përfaqëson përfaqësuesja ligjore V.I.Xh. nga Prizreni, lidhu me çështjen juridike: kompensimi i shujtave ditore, vlera e kontesti 366.00 euro me datë 26.02.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

HEDHET poshtë padia e paditëses D.B.K. nga Prizreni, në këtë çështje juridike kontestimore, për shkak të ekzistimit të gjyqëvarësisë (litispedencës).

A r s y e t i m

Paditësja D.B.K. nga Prizreni, përmes të autorizuarit të saj A.H. avokat nga Prishtina, pranë kësaj gjykate, me datën 24.08.2022, ka parashtruar padi, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit, Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt të padisë kompensimin e shujtave. Ndër të tjera në padi, i autorizuari i paditësit ka theksuar se paditësi në cilësinë e mësimdhënësit në institucionin arsimor pranë SHFMU “Zenun Çoçaj” në fshatin Gjonaj, Komuna e Prizrenit, nuk ka pranuar mjetet e parapara për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit (shujtave) në punë dhe atë në vlerë prej 2 euro në ditë, siç parashihet në kontratën kolektive dhe këtë që nga hyrja në fuqi e kontratës kolektive të arsimit në Kosovë, përkatësisht Kontratës Kolektive të Arsimit e vitit 18.04.2017, nr.2056, neni 35, par.7 dhe Kontratës Kolektive të Arsimit nr. 105, e dt. 22.01.2021, neni 35, par.7, duke kërkuar kështu kompensimin e ditëve të punës për periudhën prej datës 01.01.2021 deri me 31.12.2021.

Me parashtrësën e datës 23.02.2024, paditësja përmes të autorizuarit të saj ka bërë precizimin e kërkesëpadiisë, ashtuqë ka kërkuar nga gjykata që paditëses të i kompensohen shujtat ditore nga data 01.01.2021 e deri me datë 31.12.2021, gjithsej 183 ditë pune, në lartësi prej 366.00 euro. Po

ashtu i autorizuari i paditëses kësaj parashtrere i ka bashkangjitur edhe Aktgjykimin e GHTH në Prizren, me shenjë C.nr.3271/2022 të datës 11.07.2023.

Gjykata pas shikimit të shkresave të lëndës, aktgjykim me shenjë C.nr.3271/2022 të datës 11.07.2023, dhe përmes sistemit SMIL ka konstatuar se në Gjykatën Themelore në Prizren, është në zhvillim e sipër procedura kontestimore me shenjë C.nr.3271/2022, mes palëve të njëjta (një ndër paditësit në këtë çështje është këtu edhe paditësja D.B.K. nga Prizreni), me objekt kontesti kompensimi i shujtave ditore për vitin 2021 (nga data 01.01.2021 deri me datë 31.12.2021) dhe në të njëjtën çështje është nxjerrë aktgjykimin me shenjë C.nr.3271/22, i datës 11.07.2023.

Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, pasi që vlerësoi kemi të bëjmë me të njëjtën çështje kontestimore ndërmjet palëve të njëjta, andaj janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e këtij vendimi në kuptim të nenit 262.3 të LPK-së, ngase në mënyrë taksative është paraparë që *“gjatë kohës së ekzistimit të gjyqëvarësisë për të njëjtën kërkesëpadi nuk mund të iniciohet gjykimi i ri midis palëve të njëjta. Po që se, prapëseprapë, bëhet një gjë e tillë, gjykata e hedhë poshtë padinë”*.

Si rrjedhojë, gjykata vlerësoi se padia e paditëses D.B.K. nga Prizreni, në këtë çështje kontestimore (C.nr.2905/2022), duhet të hedhet poshtë si e palejuar, për shkak të ekzistimit të gjyqëvarësisë (litispedencës) dhe atë me lëndën me shenjë C.nr.3271/2022, në të cilën kërkohet kompensimi i shujtave ditore për vitin 2021 (nga data 01.01.2021 e deri me datë 31.12.2021). Përkundër faktit që padia me shenjë C.nr.2884/2022, është paraqitur më herët, e njëjta duhet të hedhet poshtë, pasi që lidhur me kërkesën nga padia me shenjë C.nr.3271/2022, tashmë është nxjerrë vendim meritore.

Nga të lartcekurat, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, konform nenit 262. të LPK-së, lidhur me nenin 391 nën c) të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2022:173071, 26.02.2024

G j y q t a r i

Baki Shigjeqi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 15 ditëve, pas pranimit të tij, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.